26. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për lirim nga bashkë-pagesa për Policinë e Kosovës në kujdesin parësor shëndetësor në Komunën e Pejës.
27. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në Komunën e Pejës.
28. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2025.
29. Shqyrtimi i informatës së progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.
30. Shqyrtimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2025) të Komunës së Pejës.
31. Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.
32. Shqyrtimi i informatës së Drejtorisë për Administratë, mbi funksionimin e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
33. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
34. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan znj. Drita Maloku, znj.Dafina Dragaj, znj.Zize Hakaj Veselaj, z.Berat Ganiqi, znj.Fjolla Dembogaj, z.Izet Kojic.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet

Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 17.04.2025.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 24 votë pro, 4 votë të përmbajtur, miratohet procesverbali i seancës datë 17.04.2025.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Rregullores Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një rregullore e inicuar nga drejtoria e bujqësisë për plotësim/ndryshim është rregullore që ka dal edhe në diskutim publik. Po ashtu është shqyrtuar edhe në KPF ka qenë drejtori prezent, dhe i ka sqaruar propozimet për plotësim/ndryshim të rregullores.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro, 9 votë të përmbajtur, 2 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim miratohet Draft - Rregullorja Nr. 02-2025 Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për rritjen e buxhetit të të hyrave vetanake 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një pikë që e kemi sqaru edhe në takimin e KPF-së, materialet i keni mar paraprakisht, drejtoreshen e kemi prezent nese ka dikush diqka për sqarime hapim debatin për anëtarët.

Znj.Diellza Berisha: sa i perket kesaj pike duhet të theksohet planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake në vitin 2024 ka qenë 5 milion e 365 mijë euro, ndërsa realizimi për këto të hyra ka qenë 6 milion e 309 mijë euro. Kemi një tejkalim të planit të hyrave rreth 944 mijë dhe kjo ka ardh si pasoj e gjobave të trafikut dhe gjobat që kanë ardh nga gjykata. Ne si drejtori në bashkpunim me kryetarin, i propozojmë kuvendit që të thirret një vendim që të hyrat vetanke për vitin 2024, të bëhet rritja buxhetore me vlerë 944 mijë e 848.01 euro dhe kjo të ndodhë në kategorit mallra dhe shërbime 26 mijë e 535.70 euro, në investime kapitale 918 mijë e 312.31 euro. Përkatesishtë në projektet kategoria e mallrave dhe shërbimeve: shërbimi dhe kujdesi primar shëndetsor dhe në arsim parafillorë. Kurse tek pjesa e kategorive investime kapitale në projektet: ujësjellësi për fshatrat e Lugut të Baranit, ndërtimi sheshit Hotel Korza - Ura e Zallit, ndërtimi i ures së automjeteve Kapeshticë-Qender, rindertimi i rrugëve në Rugovë nga rëshqitja e dheut, ndërtimi i hapsirave gjelbëruese buzë “Lumbardhit” dhe në lagjen “Asllan Çeshme”, ndërtimi dhe renovimi i trotuareve në qender të qytetit. Këto janë projektet e kontraktuara dhe si projekte të reja janë blerja e paisjeve të reja gjeodezike si dhe ndërtimi i trafos në shkollën “Vaso Pash Shkodrani”. Ky tejkalim kërkohet të buxhetohet për mbulimin e obligimeve të kontraktuara, si dhe për projektet e reja të cilat janë në interes të qytetarëve.

Z.Naim Bytyqi: kur jemi tek rritja e buxhetit të cilën e shohim janë 944 mijë euro dhe ky tejkalim i këtij planit ka ndodhur fal gjobave të trafikut, jo për ndonjë performance tjetër të komunes. Prap po thirrem mbas të shkresës drejtorisë e financave ka bërë propozim, që këto mjete të shpërndahen në disa projekte, për arsytim se kanë obligime të papaguara. Athëre, nese kanë obligim mjete të papaguara unë duhet të parashtoj disa pyetje. Pse nuk vjen një shkresë e saktë sa janë obligimet e papaguara? Në bazë të cilit ligj i nis projektet kur nuk ka pasur buxhet të ndar? Pse nuk i keni sjellë sot pasqyrat financiare që kishim mujt me i krahasu në bazë të pasqyrave financiare edhe të kësaj rritje? Në këtë shkresë i keni cekur që projektet janë të vitit 2025, qysh keni mujt me ndi obligim për vitin aktual? Duke i mar këto gjëra parasysh, duke i par këto gjëra jo korekte, jo ligjore unë kërkoj që prej ktyre 944 mijë euro ti ndajmë 500 mijë euro për familjet në lagjen “Asllan Çeshme” dhe lagjet e tjera që janë prekur nga vërshimet. Të drejtë ligjore për këtë kemi edhe të drejtë morale duhet me pas, në mënyrë që ti dalim ndihmë këtyre banoreve sado pak, meqenëse niveli qendror nuk j’u është përgjigjur ende! Kërkoj nga gjithë anëtarët prezentqë të përkrahni këtë propozim sepse keto lagjet “ Fidanishte”, “Asllan Çeshme”, “ Haxhi Zeka”, “ Gjemajl Kada”, janë të prekura nga vërshimet dhe keta banorë në vazhdimësi janë dëmtuar nga vërshimet dhe e kërkojnë përkrahjen tonë.

Z.Feriz Gashi: unë, e mbështesë shumë fuqishëm propozimin e z.Naim, por kam edhe diqka tjetër me shtu! Ndoshta kishte me qenë mirë që një pjesë të ketyre mjeteve të ndahet për

ndërtimin e tregut të bylmetit. Qytetarët shesin në ambijet të hapur, dhe një shumë e ketyre mjeteve kishte me qenë mirë me nda për këtë punë.

Z.Drin Veselaj: unë e kam vetem një pyetje pasi u përmend ujësjellësi i Lugut të Baranit. Pytja ime është a i keni obligimet për këtë ujësjellës? A po planifikoni me krye këtë projekt? Mendoj që kishte me qenë mirë me na tregu se qka keni planifikuar me këtë pjesë të ujësjellsit të Lugut të Baranit.

Kryetari z.Gazmend Muhaxheri: komuna e Pejës vitin e kaluar i ka pagu 7 milionë e 900 euro kontrates kolektive. Ndërsa këtë vjet jemi tek 1 milionë, para vitit tjetër kemi pagu diku 5 milionë e 600 euro. Në keto rethana pa e pas ndihmen e qeverisë ja kemi dal disa projekte me i realizu e disa janë mbet për periudha tjera. Është kollaj z.Feriz me qenë gjenroz me pare të huja, ne e kemi sjellë këtë pikë për me mujt me vazhdu dhe qeto projekte që janë jetike me i realizu. Ndërsa për projekte të tjera e vitin tjetër e hartojmë buxhetin për vitin 2026 deri në shator besojë e miratojmë.

Z. Feriz Gashi: unë që 4 vite që jam këtu nuk kam kërku asgjë për vete , por po kërkojë për këtë gjë sepse është shumë e nevojshme tregu i bylmetit sepse aty njerzë shesin në ambiente të hapura dhe nën ura!

Kryetari Gazmend Muhaxheri : shumë mirë prof që po kujtohesh për Tregun e Gjellbert edhe Tregun e Bylmetit, që 3 vjet e gjysëm është në siratarin e ministrit të juaj për me hek prej shitjes dmth është në AKP. Ish kryeministri z.Hajradinaj i ka largu prej shitjes me kërkesen e kryetarëve të komunave 12 prona. Këtë vendim e kemi anulë me preteksin që komuna duhet me pagu 20%. Komuna e Pejës e ka mar obligim me pagu 20 % që 3 vite në sirtar nuk dojnë me ja kthy komunës qato prona, që janë me ligj dhe në bazë të PZHK me ju kthy komunës së Pejës. Nuk mundemi me i nda paret ato kanë qenë të ndara mirpo prona nuk i është kthy komunës. Ajo pronë për momentin është në menxhimin e AKP-së dhe nuk mundemi me nda mjete për me krye këtë punë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro, 5 votë kundër, 7 votë të përmbajtur, miratohet propozimi për rritjen e buxhetit të të hyrave vetanake 2024.

6.Shqyrtimi dhe miratimi i bartjes së mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

Znj.Diellza Berisha: të hyrat e pa shpenzuara të vitit fiskal 2023-2024 akpin një shumë totale prej 475 ,479.70 euro. Si drejtori në bashkupnim me kryetarin i propozojmë kuvendit komunal të meret vendim për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara të vitit fiskal 2023-2024 në vlerë prej 475 ,479.70 euro dhe tejkalimi i planit të të hyrave në vlerë prej 944,848.01 euro shuma totale e tyre është 1,420,327.71 euro. Të gjitha këto mjete të barten në buxhetin e vitit 2025. Kjo bartje bëhet konform nenit 9 par.7 Ligji 03/L-332 Mbi ndarjen buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025. Kjo bartje do të ndahet në kategorit mallra dhe shërbime 41,206.60 euro, subvencione dhe transfere prej 9,550.41 eruo, dhe investime kapitale në shumën prej 1,369,270.70 euro. Si arsyetim për këtë bartje tek mallra dhe shërbime shuma prej 41,206.60 euro kërkohet për shkak të mungesës së pagesave të faturave të papaguara të vitit 2024, si dhe

për mirëmbajtjen e objekteve arsimore. Tek subvencionet destinohen keto mjete për përkrahje të fermerëve me paisje bujqësore. Tek obligimet kontraktuale mungesë të mjeteve, si pasoje e vendimeve gjyqësore. Si dhe një pjesë e këtyre mjeteve do të destinohen për projekte të reja si trafo në shkollën “Vaso Pash Shkodrani”, e cila ndihmon skollën për rrymë, si dhe për paisje gjeodezike të cilën do ta përdor drejtoria e shërbimeve publike, për kufizimin e hapsirave publike.

Z.Naim Bytyqi: pyetja ime është direkte drejtoreshë ku të teprun ty keto mjete? Ndërsa tek tejkalimi i planit të të hyrave na shpjegove që janë prej gjobave në trafik edhe prej gjobave të tjera nga gjykata. Mirpo çfarë projekte të kanë mbet pa investuar, meqenëse te kanë mbet keto mjete dhe po i qet tek mjetet tjera? Pyetja tjetër është nese nuk ishin gjobit automjetet në radar qysh i kishit pagu këto projekte? Tema është që unë po propozoj që të mbeshtett propozimi im ë të paguhen dëmet nga vërshimet. Sepse keto projektet si Lugu i Baranit nuk është duke u punu hiq dhe ju po kërkoni mjete me pagu borgje të vjetra. A mund të na shpjegoni shumë thejstë ku i keni mar keto mjete që po doni me i bartë?

Z.Labinot Panxha: përveq këtyre se qka folen koleget e pash që mjetet janë nda edhe për blerjen e një trafo! Në baze të qka duhet me ble dhe me shti rrjetin elektrik, kur e dim që atë pjesë e ka obligim Keds? Pse na duhet me bartë mjete për me ble një trafo kur e dim që është obligim i Keds a mundet mu përgjigjë dikush?

Z.Nezir Jahmurataj: u diskutuan shumë projekte që kanë mbet , po ashtu diktutan që tek mallra dhe shërbime. Unë, kam thënë shumë here që mjetet të shkojnë në projekte që j'u shërbejnë dhe të jenë të nevojshme për qytetarët. Edhe parafolsit nuk e kanë keq që me i dërgu do mjete në lagjen “Asllan Qeshme” mbasi nuk po e bën qeveria të bëjmë na si komunë. Edhe për tregun e gjelbert qytetarët shesin në pluhën dhe për qytetin e Pejës nuk i ka hije me i përzi tregjet. Prap po them vetem të i dërgojmë mjetet ku duhet dhe në menyrë të barabartë.

Kryetari Gazmend Muhxheri: Nezir, dy trafo janë tek shkolla “Vaso Pash Shkodrani”, dhe kjo shkollë është model e punuar edhe na kemi kërku me u lidh se e kemi një trafo aty para ambullantes. Keds nuk ka leju lidhjen e saj, jam mundu me i kushtëzu në njëfar menyre, mandej ka ardh prej institucioneve që kjo shkollë është me destinim special. Për shkak që është shkollë me destinim special duhet me pas edhe trafon e veçant. Edhe mua më dhimen Nezir 30 mijë euro por nuk mundet me funksion as nxemja as kurgjo pa u vendos qajo trafo. Ne kemi bër marrveshje me Keds që ata me investu në linjen e Vitomerices dhe linjen e Radavcit dhe deri në fund me fuqizu. Nese na del buxhet e bëjmë edhe pjesen e Lybeniqit por na mundemi me i ndihmu vetem me punë dytësore. Mundem me i ndihmu me qit shtylla me qel kanale por pjesa tjetër i mbet atyre për me përforcu rrjetin. Për ata senacen e kaluar kemi votu me j'u jep 11 ha për solare, për me mujt me kontribu me bo marrveshje me KEDS që na atyre diqka e ata neve diqka me na kthy me investime.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro, 6 votë të përmbajtur, 5 votë kundër, 1 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim miratohet bartja e mjeteve buxhetore të pa shpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025.

7.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Euro-Steel SH.P.K, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: këmbimi i pronës komunale me këmbimin e pronës së paluajtshme me kompaninë Euro-Steel SH.P, janë me sipërfaqe të njëjtë përafërsisht, vlera po ashtu e njëjte me qëllim të realizimit të interesit publik hapja e rruges tërthorazi (prezentim në projektor).

Z.Drin Veselaj: meqenëse këtu kemi shumë pika për këmbimin e pronave, na si grup në vazhdimësi tash 12 vite jemi deklaruar se këto shumica e ketyre janë këmbime në interesa të ngushta personale dhe vazhdojmë me mendu njëjtë! Sigurishtë mendimin e keni të bazuar edhe në fakte. Nëse i lexon të gjitha pikat e shohim që këto këmbime janë për interesa për persona të caktuar dhe sigurishtë kryetari e din pse këto prona i ndron. Për mua si asambleist që nga 2013 –ta unë e kam pa qëllimin e kryetarit për këmbim të pronave dhe ka qenë prioritet i tij me i bo këto këmbime të pronave. Veç një e mire është në këtë punë se besoj që janë këmbimet e fundit që i bën kryetari dhe për këtë i ka sjellë sot këtu të gjitha! Sepse nuk ka me pas mundësi me ndru mo, pasi që kryetari i ri që vjen shpresoj që ka me pas qasje më ndryshe se ky kryetari dhe ka me lënë pronën publike në dispozicion të qytetarëve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro, 10 votë kundër, 1 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Euro-Steel SH.P.K.

8.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton (Sali) Kelmendi - me shtëpi, pronë e pronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me qëllim të realizimit të interesit publik - ndërtimin e objektit të ri të Administratës Komunale, përkatësisht ndërtimin e rrugës tek ura e re.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: sipas materialit të dërguar kryetari ju prezanton në projektor asambleistëve të pranishëm, këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton (Sali) Kelmendi pronë e pronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me qëllim të realizimit të interesit publik - ndërtimin e objektit të ri të Administratës Komunale, vlera për afërsisht të njëjta dhe po realizohet diçka e mirë në një rrugë qore me pronën e ketyre pronarëve të lartëcekur.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro, 7 votë kundër, 1 votë e përmbajtur, 4 anëtar nuk kanë marrë pjesë në votim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve private.

9.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarëve Atdhe (Sali) Kelmendi dhe Rezarta (Muhamet) Kelmendi, me qëllim të realizimit të interesit publik - ndërtimin e rrugës tek ura e re.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: kryetari sqaron dhe ju prezanton sipas materialit në projektor asambleistëve prezent .

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (një votë me ngritje dore), 9 votë kundër, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarvë private

10.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Besnik Osa - shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik - rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: Pika në vazhdim ka të bëjë me një kërkesë të Kryetarit të Komunës, lidhur me këmbimin e një prone komunale e cila ka të bëjë me rritjen e sigurisë pasi që prona ndodhet në zonën e rrezikuar nga vërshimet në lagjen Asllan Qeshme, përkatësisht në një zonë ku kemi pasur problem të reshjeve.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: janë tri prona aty, e familjes Ademaj ku ndodhi edhe tragjedia, e familjes Osa që është shtëpia në grop krejt dhe familja Havolli. Kryetari ju prezenton në projektor dhe ju tregon që për këtë nuk ka ardh vlersimi ende, por ju lus ta votoni pastaj e bashkangjitim në dokumentacion. Disa vlersime na kanë ardh dhe disa të tjera jemi duke i pritur!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (një votë me ngritje dore), 5 votë të përmbajtur, 4 anëtar nuk kanë mar pjesë në votim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarvë private

11.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Luan (Dervish) Dervishaj, “Geshtenja Company” dhe Bekim (Sahit) Berisha, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri, sqaron këmbimin e pronës dhe ju prezenton në projektor asambleistëve të pranishëm këmbimin e pronës me qëllim të realizimit të ndërtimit të rrugës.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (një votë me ngritje dore), 10 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarvë private.

12.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luan (Dervish) Dervishaj, me qëllim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e rrugës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Kjo pronë është e ndarë nga ajo që u përmend në pikën e kaluar, dhe këtë prone po e ndrojmë me parcelen që është në Brestovik e cila I ka 150m2. Kryetari prezenton në projektor asambleistëve të pranishëm këmbimin e pronës e cila për të përfunduar projektin e rrugës është e nevojshme që të bëhet edhe këmbimi i kësaj pjese të pronarit Luan Dervishaj.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (një votë me ngritje dore), 9 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qëllim të realizimit të interesit publik.

13.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Luigj (Ilhami) Karagjija me shtëpi në pronësi, me qellim të realizimit të interesit publik – ndërtimin e shtëpisë për komunitet.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: Propozimi tjetër lidhet me ndërtimin e një shtëpie për komunitet në lagjen Kapeshnica, si kjo shtëpitë e fshatit mirpo kjo ka më shumë punë përcjellëse si parking, fushë loje për komplet lagjen për krejt lagjen e Kapeshnices. Në këtë pronë aktualisht ndodhet një shtëpi banimi Për realizimin e këtij projekti, është e nevojshme që Komuna të marrë pronësinë përmes këmbimit të pronës komunale me këtë pronë private. (kryetari prezenton në projektor).

Z.Naim Bytyqi: nuk ish dasht me u përzi piken që e kërkova unë për ndihmë financiare për lagjen “Asllan Qeshme” dhe lagjet tjera. Të cilat janë dëmtu nga vërshimet të mos përziehet me ndrimine pronave sepse ndihma financiare o tjetër dhe shpronësimi është tjetër, këto dy gjëra mos i përzini. Sepse po ka tendenca me na lon fajator qe shpronësimet spo i votoni e po kërkoni me ju ndihmu asaj lagje. Një pyetje konkrete për kryetarin nese një pronë komunal po e supozojmë 50 ari e qesimi në tregun e lirë edhe një pronë të një qytetari po ashtu 50 ari në vende të ndryshme, a e kanë çmimin e njejtë?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: egziston sipas ligjit një komision në ministrinë e financave i cili i vlereson këto prona në bazë të rregullores së ministrisë së financave. Kta e bëjnë vlersimin nese ka diferencë në çmime ose pagun komuna pronarit privat ose anasjelltas.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (një votë me ngritje dore), 10 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim të ndërtimit të shtëpisë për komunitet.

14.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Milaim (Azir) Ademaj, me qellim të realizimit të interesit publik – rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

Kryetari Gazmend Muhaxheri, prezenton në projektor shtëpinë e familjes Ademaj e cila është e ndërtuar në grop ku fatkeqësishtë aty ndodhi edhe tragjedia. Edhe kjo nuk ka vlersim por ju ftoj ta votoni

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 1 votë kundër, 4 votë të përmbajtur dhe 7 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim realizimit të interesit publik – rritjen e sigurisë nga vërshimet eventuale në lagjen Asllan Qeshme.

15.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Muhamed Havolli, me qellim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: kjo është prona e tret në këtë lagje gjysen e pronës e ka rrugë dhe gjysen e pronës e ka shtëpi (kryetari prezenton në projektor). Edhe për këtë pronë nuk ka ardh vlersimi.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro (dy votë me ngritje dore), 5 votë kundër, 4 votë të përmbajtur dhe 4 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim realizimit të interesit publik – zgjerimin e rrugës.

16.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarve Mehribane Shala me 1/3, Fatmir (Vehbi) Muhagjeri me 1/3 dhe Mazllom (Vehbi) Muhaxheri, me qellim të realizimit të interesit publik – qasje në rrugë.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: edhe kjo pikë është vazhdimi i rruges së njëjtë, këmbim i pronës është vlera e njëjtë sipërfaqja e njëjtë dhe vendi i njëjt (kryetari prezenton në projektor).

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 10 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim realizimit të interesit publik – qasje në rrugë.

17.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Mustafë (Ramë) Lajçi, me qellim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës ekzistuese.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: edhe ky këmbim bëhet me sipërfaqe të njëjta, këmbimi bëhet për qëllim të zgjerimit të rrugës ekzistuese (kryetari prezenton në projektor). Po ashtu deklaron që edhe për këtë pikë nuk ka ardh vlersimi.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 9 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim realizimit të interesit publik zgjerimi i rrugës ekzistuese.

18.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Reliumd Group SH.P.K., me qellim të realizimit të interesit publik.

Kryetari Gazmend Muhaxheri prezenton këmbimin e pronës në projektor për të gjithë anëtarët prezent, ju sqaron që vlersimi nuk ka ardh ende por ju ftoj ta votoni pastaj e kompletojmë në dokumentacion.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 10 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qellim realizimit të interesit publik.

19.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Rexhë (Avdi) Muriqi, me qëllim të realizimit të interesit publik.

Kryetari Gazmend Muhaxheri:kjo pronë është përballa kazernes së ushtrisë ku është KFOR një parcelë 1ha e pak, po i ofrojmë pronarit edhe ky vlersim nuk ka ardh por po e votojmë pa vlersim. Nese e aprovon ministria mire që jo mbetet për më vonë!.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 9 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit private me qëllim realizimit të interesit publik.

20.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të bashkëpronarëve Salih (Bekë) Lajqi me 5/12, Ali (Sadik) Abazaj me 5/12 dhe Sali (Shaban) Lajqi me 2/12, me qëllim të realizimit të interesit publik – zgjerimi i rrugës.

Kryetari Gazmend Muhaxheri kryetari prezenton këmbimin e pronës në projektor për qëllim të realizimit të interesit publik, po ashtu cekë që edhe për këtë pronë nuk ka ardh vlersimi.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 9 votë kundër, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarët private me qëllim realizimit të interesit publik zgjerimin e rrugës.

21.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Xhemë (Arif) Rexhbogaj - me shtëpi në pronësi, me qëllim të realizimit të interesit publik – krijimin e hapësirës së hapur rekreative dhe gjelbërim

Kryetari Gazmend Muhaxheri: prona e pronarit privat Xhemë Rexhbogaj është te mulliri "Haxhi Zeka" ngastra me nr.237/9 me sipërfaqe 387m² e kemi dërgu me ndru e cila janë 6 parcela dhe kjo koka e fundit(kryetari prezenton në projektor), këmbimi bëhet me qëllim të krijimin e hapësirës së hapur rekreative dhe gjelbërim. Vlersimi ka ardh dhe kjo pronë të pronarit privat është vlersu në shumën prej 260mijë e 290 euro, ndërsa këto tjerat janë 505 mijë euro. Me këtë interpretim që po e bën ministria ne duhet me i votu të barazume. Keto mundem me u barazu prona nr.1 me pronen nr.6 dhe me dal vlera e barabartë, ose keto pronat tjera me i mbeldh prap dhe qaty vlera barazohet. Ne po e votojmë ndrimin e barabartë edhe këtë pjesë që po e votojmë edhe piken tjetër me ½ me përmbush këtë obligim.

Z.Islam Husaj: cilin variant po e votojmë tash?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: po e votojmë barazimin nr.1 dhe nr.6 e afrojmë 100% çmimin.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 9 votë kundër, 1 votë e përmbajtur miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarët private me qëllim të krijimit hapësirës së hapur rekreative dhe gjelbërim.

22.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Sali (Ibrahim) Gashit, me qëllim të realizimit të interesit publik.

Kryetari Gazmend Muhaxheri prezenton në projektor për të gjithë anëtarët prezent pikën e fundit të këmbimit edhe për këtë nuk kemi vlersim.

Znj.Eleonora Bala: unë mendoj që nuk ish dasht me i votu këto pika që nuk kanë pasur vlersimin. Po më duket e pa kuptim që po votojmë diqka, që nuk e dim a kanë me u vlersu dhe spo kuptoj qka është kjo nguti! Këto që nuk janë vlersu ish dasht me i lon për hera të tjera.

Z.Labinot Panxha: me qëllim e lash piken e fundit me diskutu në lidhje me këmbimin e ketyre pronave. Vetem për faktin që edhe për qytetarët që po na përcjellin, por edhe ne që jemi ktu me pa prezentimin e kryetarit në PowerPoint këmbimin e ketyre pronave. Kryetar, përnime je i fortë dhe këtë po e them vetem që nuk i trembesh ligjit. Interessant na askund nuk e pam që këto prona janë në kufi kadastral me njëra-tjetren qysh e përcakton ligji. Askund nuk e pam që na preznetove ndonjë dëshmi që ato prona nuk e kanë ndonjë kontest gjygjësor! Sepse ata ka mundësi që munden me pas vëllëzrit ndërmes vete ndonjë kontest gjygjësor. Po ashtu e pam që këto pronat që i prezentove do vija, do rrugë të vogla, dhe ajo që është më e rëndësishmja që asnjëra nga këto prona nuk kanë ardh konform ligjit për këmbim të pronës komunale. Dhe shumica prej tyre nuk kanë për qëllim përmbushjen e interesit publik duke të përfshir edhe ty! Unë, po mendoj si parafolsit e mi që ndoshta është këmbimi i fundit që bëhet në këtë formë. Sepse këmbime duhet të ketë por të fushës së interesit publik. Nuk duhet të ketë të përmbushjes së interesave të njërëzve të caktuar, që kanë afërsi me pushtetin ose me kënd do që ata e kanë! Uroj shumë që kjo të jetë e fundit, që sot këmbet në këtë menyre.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: të gjitha janë kto interesa publike të cilat kryetari i propozon edhe anëtarët që po i votojnë i kisha falenderu, edhe ata që po na dëgjojnë me ju tregu që të gjitha janë në interes të publikut. Ndërsa për këto 7 prona që i votum e nuk janë të vlersuara për gjitha e kam ndërmend me shku në gjygj me ministrinë. Këto janë probleme administrive dhe për këtë arsye tash e mbas kemi me shku në gjykatë.

Z.Islam Husaj: një pyetje deshta a është ligji i njejt që po i ndrojmë pronat edhe vjet edhe sivjet? Gjashtë vite më përpara se me ardh ju si kryetar ne i kemi ndru pronat, por i kemi ndru me një komision komunal që i ka vlersu. Edhe athere është kërku me qenë nga ministria mirpo ne e kemi pas një komision ktu dhe i kanë v lersu. Mandej edhe 10-11 vite i kemi bë këmbimin e pronave pastaj është bë vlersimi. Tash po duhet me u bë paraprakisht vlersimi. Cili nen ka ndryshu në ligjin para 6 mujave? Që 18 vite ndrymë prona kemi ndru edhe athere kur nuk ke qenë kryetar, edhe vazhdimishtë dhe duhet me ndru prona, sespe nuk zgjidhen problemet e qytetarëve

pa i bë edhe kto ndryme. Vlersimet e ministrisë i presim a janë të ligjshme apo jo pastaj veprojmë.

Z.Labinot Panxha: doktor këtë pyetje e bëre me vend, por kishte me qenë mirë me i marr njëherë vlersimet. Nese pajtohen me vlersimin e bjen në kuvend e këmben, e nese nuk pajtohem. Athere nese nuk pajtohem nuk vjen në kuvend, po mendoj që ky është edhe qëllimi i tyre.

Z.Islam Husaj: unë e kam provu edhe pozitën edhe opozitën. Po ashtu edhe i kam përmend edhe punët e mira që i ka bo kryetari e qeveria e atëherë. Pastaj i kam jep edhe vërjetet e mija për atë që kam mendu që nuk është mirë! Po i marr vetëm këto 4 vitet e fundit po thash që qeverisja lokale nuk ka bo asnjë punë të mirë? Asnjë nga ju opzita nuk e keni përmend një punë që është bërë mirë. Ne si anëtar të kuvendit duhet me qenë në shërbim të qytetarëve dhe ndihmes ndaj tyre. Po ashtu komuna e ka për obligim me i dal në shërbim për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve.

Z.Bujar Agusholli: vetëm një pyetje për ju këshillaret e pozitës, më tregoni vetëm një rast që ju e keni kundërshtu diçka që nuk është në të mirën e interesit publik? Nuk kemi nevojë për motivim dr.Islam këtu secili e përfaqëson vetveten.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 9 votë kundër, 1 votë e përmbajtur miratohet propozimii i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit Sali (Ibrahim) Gashit, me qëllim të realizimit të interesit publik.

23.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit në bashkëfinancimi të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).

Znj.Hidajete Krasniqi: materialin e kemi marr dhe shumë mirë o shkrun kriteret që duhet me i pas për subvencionim. Kisha kërku nga drejtori një arsyetim se perse nuk na vjen në materialin me emrat e atyre që janë përzgjedh për subvencionim dhe t'i diskutojmë këtu cilët janë emrat e përfituesve? apo i keni të gjithë me librezë të partisë, sepse ne kemi mar ankese që një person sigurt drejtori e din për kend bëhet fjalë që është heq nga lista!

Z.Tahir Shala: në përgjigjen e pyetjes tuaj, emrat , komisioni dhe të gjitha janë publike.Në rastin konkret është bërë gabim teknik në numer por ne jemi mar vesh me atë që rastin tjetër kemi me i ndihmu. Ju keni qasje në dokumenta zyrtarë dhe mundeni me i shiku të gjithë përfituesit!

Znj.Hidajete Krasniqi: shumë e qartë por në materialin nuk ka ardh asnjë listë, sepse ne nuk kemi kohë ndonjëherë edhe për faqe tjera. Por kur vjen materialin i kuvendit e kemi për obligim me shiku me kujdes!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro (dy votë me ngritje dore), 2 votë kundër, 7 anëtar të përmbajtur miratohet buxheti i bashkëfinancimit të Komunës së Pejës - participimi nga qytetarët (fermerët përfitues).

24.Shqyrtimi dhe miratimin i Draft - Rregullores për Transparencë në Komunës së Pejës si dhe draft-planin i Veprimit për Transparencë (2025 – 2029).

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është një rregllore që komuna duhet t'a përpiloj dhe ta miratoj në kuvend. Kjo rregullore për transparencë përmban kriteret që duhet ta respektojnë kryetari i komunes, drejtoritë, ekzekutivi dhe kuvendi që ka të bëjë me qytetarët në vendimmarrje. Janë procedura të cilat duhet ti përmbahemi në transparencë kur është fjala tek performanca e Komunës së Pejës

Nga të gjithë anëtarët prezent me 20 votë pro (dy votë me ngritje dore), 6 anëtar të përmbajtur miratohet rregullorja për Transparencë (2025-2029).

25.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit - Komuna e Pejës.

Z.Nysret Hajrizi: sot kam kënaqësinë e veçantë të ju drejtohem në emër të drejtorisë për zhvillim ekonomik një moment me dëmthënje të madhe për të ardhmen e komunës tonë. Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit në komunën e Pejës. Turizmi nuk është thjeshtë një mundësi por është një prioritet strategjik për komunën e Pejës. Ne e kemi pasurinë natyrore, trashëgimin kulturore, dhe ajo që na veçon mikëpritjen. Ajo që ka munguar deri me tani është një qasje e koordinuar dhe një plan afatgjatë për ti shërbyer këto resurse dhe gjysëpërfshirëse. Me këtë strategji po e plotësojmë këtë boshllëk. Strategjia që sot po e miratojmë është një punë e përkushtuar dhe bashkëpunuese dhe me kontributet e përfesionistëve të fushës. Andaj të ndëruar kuvendar të qytetit të Pejës, strategjia e turizmit në komunën e Pejës përfaqëson dokument gjithëpërfshirës dhe vizionar. Që synon të vendosë Pejën një destinacion të qëndrueshëm dhe konkurrues në hartën ndërkombëtare të turizmit. Me këtë rasyt i falenderoj Swiss Kontakt dhe PPSE për përkrahjen dhe përpilimin e këtij dokumenti strategjik. Po ashtu falenderoj stafin e drejtorisë për zhvillim ekonomik. OJQ-të, Guiden Turistike të Pejës dhe operatorët ekonomik që janë të lidhura direkt me turizmin dhe mbi të gjitha falenderoj qytetarë gjithë falenderoj qytetarët e Pejës që janë bashkë krijuar këtë vizion. Sepse turizmi që është i qëndrueshëm fillon me njerzit dhe me bashkëpunimin lokal.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro (dy votë me ngritje dore), 8 anëtar të përmbajtur miratohet Strategjia për Zhvillimin e Turizmit - Komuna e Pejës.

26.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për lirim nga bashkë-pagesa për Policinë e Kosovës në kujdesin parësor shëndetësor në Komunën e Pejës.

Znj.Hidajete Krasniqi: ne si grup nuk jemi kundër aprovimit të kërkesës për lirim nga pagesa për kërkesën e sindikates të policisë. Ne e dim që kujdesi parësor, dytësor dhe tretësor rregulloja për bashkëpagesa vjen nga ministria e shëndetësisë. Pyetja ime është se në qka doni me u bazu me i lir nga bashkëpagesa? Në të njëjtën kohë nëse meret parasysh pjesa e policisë, unë kam një kërkesë të meret parasysh të lirohen edhe punëtorët shëndetësor. Duke marrë parasysh se as ata nuk kanë sigurime shëndetësore përpos që kanë rezikshmëri me jetë dhe dhunë fizike, në të dy anët kanë rezikshmëri. Kërkoj të meret parasysh që edhe puntoret shëndetësor të lirohen nga bashkëpagesa.

Znj.Eleonora Bala: ne të gjithë e dim rolin e policisë së Kosovës dhe jemi shumë krenar me punën e tyre. Por mendoj që këtu do të duhet të shtojmë edhe punëtorët e higjenes që edhe ata të lirohen nga bashkëpagesa, nëpunësit e prokurorisë, arsimit edhe punëtorët shëndetësor dhe t'i lirojmë të gjithë.

Z.Islam Husaj:unë mendoj që të hyrat nga participimit janë të hyrat vetanake të cilat i shfrytëzon komuna për nevojat e veta dhe mundet me mar vendim me i liru në dëm të participimit nga kjo kategori. Unë e kam një çështje në kërkesen që e kemi në material të sindikatës thuhet: të lirohen nga kujdesi parësor dhe kujdesi sekondar. Ne nuk jemi kompetent për nivelin sekondar, jemi vetëm për nivelin primar. Kshtuqë duhet me pas parasysh që kur meet vendimi që ne nuk jemi kompetent për nivelin sekondar, sepse ata janë tjetër shtëpi.

Z.Petrit Loci: vetëm deshta me potensu që është një kërkesë që ka ardh nga sindikata e policisë është inicu prej tyre dhe ka qenë detyrë e imja ta prezentoj para jush, dhe është në doren e juaj me miratu individualisht secili materialin e keni pas bëhet fjalë për lirimi i bashkë-pagesave.

Z.Bujar Agusholli: nese policia e trajton veten si të veçant në shtetin tonë, mos të harrojmë zjarrfiksat që janë edhe më të veçant, edhe arsimin që e bën edukimin. Athere të bazohen vetëm në atë që ka mendu shteti se cilat kategori me i liru, dhe me kish ardh keq me qenë në vendin e tyre me veq veten në keto situata.

Z.Labinot Panxha: mos me u keqkuptu nga kolegja ime znj.Hidajete, udhëzimi administrativ 03/2024 nuk e parasheh lirim e policisë nga bashkë-pagesat. Unë, e kam një pyetje për kryetarin, drejtorin meqenëse është kërkesë e sindikatës së policisë për me u liru nga bashk-pagesat nese ky kuvend sot e aprovon, në seancën e radhes ka me ardh sindikata e zjarrfikseve, sindikata e të tjerëve a keni me vepru njëjtë? Sepse ne si kuvend nuk mundemi me punu në mënyrë diskriminuese dikën me liru e dikënd jo! Prandaj ju nuk e shpjeguat se si doni me vepru e me pas me na mbush mendën edhe neve që me i mbështet a po jo, mirpo me argumente.

Znj.Hidajete Krasniqi: secili e cekem sa të rëndësishëm janë shtyllat, por unë kam me inkurju sindikaten e shëndetësisë që me bo kërkesë si sindikata e shëndetësisë primare, sindikata e zjarrfiksave e arsimit të gjithë kanë të drejtë. Mirpo athere sigurisht buxheti i komunes ka me u dëmtu sespe nuk kemi bashkë-pagesa prej qytetarëve.

Z.Atdhe Berisha: unë kërkoj që kjo pikë me u shty për në një senacë tjetër me u shqyrtu me kujdesë dhe me gjërë kjo pikë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nese jeni dakord shefat e grupit për me shty për një senacë tjetër athere votjmë

Z.Rajan Arapi: ne si grup e patëm në plan me votu sespe e shohim efikasitetin e sindikates që ka policia. Pra nese një sindikates i ka ra ndër mend me punu dhe me u angazhu në sektorin të cilën bën pjesë, athere pse mos me votu? Nuk besoj që këtu është kundër policisë dhe meqenëse ka ardh kërkesa nga policia atëhere t'a votojmë. Nese vin kërkesat në të ardhmen nga grupet tjera athere i shqyrtojmë. Por siq tha edhe profesori këto kërkesa kanë vetëm me u rrit , pastaj a kena mundësi me i votu të gjitha do ta shohim!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: me kërkesë të shefave të grupeve që kjo pikë të hiqet nga rendi i dëtes me shqyrtu në një seancë tjetër për shkak që është një situatë e ndishme edhe për sindikatat e grupeve tjera. Votojmë tani me ngritje dore për me shty këtë pikë për sencë tjetër.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 22 votë pro, 1 votë e përmabjtur, aprrvohet që kjo pikë të shtyhet për një senacë tjetër.

27.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në Komunën e Pejës.

Znj.Hidajete Nikçi: unë e kam një këshillë sa i përket anëtares së komisionit nga këshilli i prindëve, kishte me qenë mirë me qenë dikush tjetër. Pasi që kjo antarja nuk ka fëmi që vijon në atë shkollë dhe mendoj që pasi nuk ka fëmi në shkollë si mund të përfaqësoj këshillin e prindërve!

Z.Naser Gega: ky komision është i njejtë me atë të herës së kaluar, nese nuk i ka në këtë shkollë atëherë i ka në një shkollë tjetër. Prind është dhe pasi që e ka kry punën në përpikëmeri andaj për këtë arsye propozu të njejtën.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 16 votë pro (dy votë me ngritje dore), 2 votë kundër 7 anëtar të përmbajtur miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve.

28.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e keni mar vendimin senacën e kaluar për formimin e komisionit, pranimin dhe shqyrtimin e propozimeve që vijnë për tituj nderi, mirënjohje, dekorata dhe falenderime. Materialin e keni mar nga DKRS-së dhe komisionit që kanë bashkëpunu për vendimin e tyre që janë dakorduar të marin çmime!

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: vetem po e theksoj që ne si drejtorat e kemi bër vetem procesin e administrimit, i cili ka filluar nga thirrja publike. Thirrja ka zgjatur 35 ditë pastaj pranimi i vendimit të komisionit, ftesa e punës në komision dhe prezentimi i të gjitha dosjeve që kanë mbri edhe nga kabineti i kryetarit dhe i asociacioneve tjera. Gjithë ajo punë që është bër i keni të përmbledhura në materialin të cilin ju kemi përcjellë në rendin e dities.

Z.Labinot Panxha: ne i kemi pa propozimet dhe besoj shumë që janë të qëlluara. Unë shprehi mirënjohje për ata njerzë që kanë kontribu dhe kontribojnë në mbushje të buxhetit të shtetit, dhe janë taksapaguesit më të mëdhaj siq janë vëllëzrit Devolli, Ekrem Lluka dhe Ramiz Kelmendi. Ky vlersim është i vonuar nga ana juaj , është i qëlluar ne si aleancë do ta mbështesim në shenje mirënjohje dhe respekti për ata njerzë të cilët kanë mbushur edhe buxhetin shumë familje në komunën e Pejës dhe me gjërë, dhe të njejtin me të vërtet e meritojnë titullin “Nderi i Qytetit”.

Znj.Mubera Belegu: unë kam qenë antare e komisionit, siq e cekim edhe drejtoresha që kemi pas takime dhe janë të prezentuara në procesverbal të gjitha dosjet e protokoluara. Në takimin e parë kanë mungu nga PDK-ja dhe Izet Kojic. Ndërsa në takimin e dytë më vonë janë bashkangjitur të gjithë. Në procesverbal e dytë e kam pa që e keni cekë që jemi dakorduar anëtarët për gjitha emrat. Materialin e kam përpara propozimin e kryetarit “Qytetar Nderi” kurgjo nuk jam kundër shumica më kanë pelqy, mirpo tek titulli “Nderi i Qytetit” përshtet ne si VV jemi kundër. Në pika të shkurta mundem me fol për disa! Shumë e vërtet që këta kanë kontribu dhe kanë punësuar njerzë dhe po e them një shprehje “kanë jep me një dorë e kanë marr me dy”. Po flas me radhë z. Ramiz Kelmendi, e ka furnizuar Kosovën me artikuj nga Serbia dhe e ka pasur Serbin e kta neve as nuk na kanë pranuar. Nese o kjo Nderi i Qytetit dhe Çështje Kombëtare, atëherë për

neve nuk është me pasuru Sërbinë. Për z.Ekrem Lluka, me vite j'a keni jep parkingun e "Hotel Dukagjinit" dhe për çdo vitë përfiton 300,400 mijë euro, ndërsa me një shumë simbolike j'a paguan qiranë komunes. Sa i perket vëllëzëri Devolli, nese është për ju çështje kombëtare që ka kontribu me regjistru kompanin Gjakovica, Serbia për neve është tradhëti.

Z.Atdhe Berisha: mbështesim punen e komisionit, gjithashtu edhe propozimet. Po ashtu edhe deshta me u ndërlish me kolegen që tha për z.Ramiz Kelmendi, po harron që kur vishin kamionat nga Serbia i kanë rrotullu e tash ju kanë hap kufijtë mirë se vini!

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: për hir të së vërtetes dua ti shpalos edhe disa argumente. E para e punës që kur një asambleistë të zgjidhet të i dij të gjitha ligjet dhe rregulloret në komisionin ku prezentohet dhe ku pranon të zgjidhet. E dyta e punës të gjitha rregulloret e vëndimarrjes janë të paraqitura ndërvite dhe është shumë e lehtë të ket qasje në rregullore. Shumë mirë do të ishte që së pari të lexohet rregullorja para se asambleisti të vi dhe të mar pjesë në komision. Detyra e komisionin është që vetem të shikoj materialin, dhe bën verifikimin e dosjes se a është e plotësuar për një kandidat. Fatmirësishtë në të dyja procesverbalet që janë mbajtur kanë pas korum të plotë, dhe të gjithë ata që kanë qenë në korum janë edhe ktu prezent. Ndërsa znj.Belegu në këtë rast e ka pranuar procesverbalin dhe e ka nënshkruar dhe ka ardhur me dëshiren e saj! Por ajo qka është me trisht që të nesërmen ka ardhur dhe ka pas ambicie të ndërhyjë në procesverbal. Duke pasur parasysh që keni jurist në strukturen tuaj politike ish dasht të konsulltoheni fillimishtë se çfarë vepr penale është të ndërhysh në procesverbal. Ndërsa sa i perket z.Labinot Panxha e falenderoj ndryshe që ka abstenuar të jetë antar i komisionit , i pranon vlerat e komunës tonë sespe vetem me vlera mund të ngritemi dhe të integrohemi.

Z.Rajan Arapi: në emer të grupit sepse bisedova edhe e ata e mbështesim listen, dhe mendoj që çdo here kanë qenë listat e mira për tituj nderi. Kësaj radhe mendoj që ka qenë listë e kompletuar, njerëz të merituar.

Z.Nezir Jahmurataj: më vjen mirë që Labi e paska përkrah listen, edhe une po them lum Peja që ka njerzë të mirë mirpo edhe ne ju japim! Unë po them vetem le t'i kompelton secili individ kriteret reale të Pejës se qka ka hek në këtë 50-vjet. Kemi plotë njerzë për me i nderu kemi këpucëtar dhe zanate të tjera dhe ne si qytetarë dhe përfqësues të popullit kishte me qenë mirë me i përfshi edhe këtë në listë edhe njerzë që kanë punu për atdhe, arsim etj.

Z.Islam Husaj:a ka kërkesa që kanë ardh në komision dhe i keni refuzu? Nese nuk ka asnjë refuzim athere është faji i atyre që po flasin, sespe është dasht me i propozu qytetarët që i meritojnë keto tituj nderi apo dekorata tjera. Nuk munden me fol dhe me ja lon fajin komisionit i cili ka kry vetem proceduren administrative e jo me propozu njerzë.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: dr.Islam, ata që kanë qenë seriozishtë të interesuar i kanë kompletuar dosjet pa asnjë boshëllëk. Në momentin që dosja përgatitet pas asnjë boshëllëk, komisioni nuk ka drejtë ta refuzoj. Po e them me përgjegjësi të plotë që nuk ka asnjë refuzim sepse çdo propozim ka ardh me kohë dhe i kompletuar sikurse e kërkon rregullorja dhe ky kuvend.

Z.Feriz Gashi: unë kam qenë njëher antar i këtij komisioni, drejtoresha ka tëdrejtë kur thotë i plotëson kriteret dhe smundemi me refuzu. Mirpo problemi është ktu, ne në kuvend a mundemi

me refuzu? Këtu është problemi ne po na vijn paket 10-15 veta sa janë të propozuar, unë ndoshta kisha votu kundër ndonjerin prej tyre. Po i futni dhjetë të mirë e po e zëjm dy jo, ndërsa na për shkak atyre 10 të mirëve duhet me i votu edhe ata dy që nuk e meritojnë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj, i lëxon emrat e kandidatëve të propozuar:

1. Titulli “Qytetar Nderi” - Timo Flloko,
2. Titulli “Qytetar Nderi” - Halil Kastrati,
3. Titulli “Qytetar Nderi” - Zija Mulhaxha,
4. Titulli “Qytetar Nderi” - Rosaria Succurro,
5. Titulli “Qytetar Nderi” - Ukë Hysen Nimani,
6. Titulli “Qytetar Nderi” - Post Mortum - Xhevdet Ademaj,
7. Titulli “Qytetar Nderi” - Post Mortum - Dervish Avdijaj,
8. Titulli “Nderi i Qytetit” - Ramiz Kelmendi,
9. Titulli “Nderi i Qytetit” - Ekrem Lluka,
10. Titulli “Nderi i Qytetit” - Blerim Devolli,
11. Titulli “Nderi i Qytetit” - Shkelqim Devolli,
12. Titulli “Lekë Dukagjini” - Gëzim Muriqi,
13. Titulli “Azem Shkreli” - Post Mortum - Sylë Osmanaj,
14. Titulli “Mirënjohje” - Shoqata e Sportit,
15. Titulli “Mirënjohje” - SHBA “Gjeravica”,
16. Titulli “Mirënjohje” - Vehbi Shala,
17. Titulli “Mirënjohje” - Mevlyde Pupovci

Nga të gjithë anëtarët prezent me 18 votë pro (dy votë me ngritje dore), 5 votë kundër, miratohet propozimi i komisionit për tituj nderi, dekorata, mirënjohje dhe falënderime për vitin 2025.

29.Shqyrtimi i informatës së progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: raporti i auditorit të jashtëm nuk është përfundimtardhe nuk mundet me u diskutu në këtë seancë, kjo pikë e rendit të dites do të bartet diku kur të jetë i gatshëm raporti i auditorit të jashtëm.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: meqenëse e kemi në paln të kuvendit këtë pikë e kemi vu në rend dite. Meqenëse nuk ka ardh materiali, athere në momentin që marim raportin nga kryetari dhe ekzekutivi athere mund të qesim për shqyrtim në seancën e kuvendit.

Z.Drin Veselaj: këtu po shkrun raporti i progresit ska lidhje me raportin e auditorit, këtë është dasht ekzekutivi. Pse kjo vonesë? Apo nuk keni mbi kryetar me e i kry ato se çka j’u kanë rekomandu auditori se gjatë gjithë kohes vetem ju kanë shto kto!

Kryetari Gazmend Muhaxheri: raporti i progresitë se tash ky në 25-en i kqyr sa pika i kemi përfunduar të 24-es dhe qat progres auditori i jashtem duhet me evoluar për krejt komunat i aknë sjellë, vetem komunës së Pejës nuk ja kanë sjellë!

30.Shqyrtimi i informatës tremujore financiare (janar –mars 2025) të Komunës së Pejës.

Z.Naim Bytyqi: duke mar për bazë disa shpenzime të cilat unë kam pas vërejtje gjithmonë, në këtë raport janë më të ulta shpenzimet dhe janë konform norma financiare. Mirpo unë deshta me i parashu disa pyetje tek mallrat dh sherbimet Kodi ekonomik 14032. Mirëmbajtja e autoudhëve lokale. Nese e shohim në vitin 2024 në këtë kod kanë qenë të planifikuara 531.000 euro. Kurse tani janë të planifikuar 836.000euro. Tash 300.000 euro më shumë dhe po më shkon mendja pse është rrit se tash jemi në prag të fushates dhe duhet me shtru asfalt të më shumë. Pyetja tjetër është tek subvencionet plani është 1.2 milionë për tre muaj, ndërsa ju i keni shpenzuar vetem 10%. Në kushte normale ish dasht me u shpenzu dhe me ju dhënë sportistave, klubeve besa edhe njerzëve që kanë sëmundje dhe nevoja të ndryshme. Si raport idh dasht me kon transparent, sespe nuk është lista e projekteve që janë kry pagesat. Andaj kërkoj zyrtare që në 6 mujorin të bashkangjitet edhe lista e projekteve kapitale të cilat projekte u kry pagesa.

Znj.Hajrije Haxhijaj për shkak të problemit tekin nuk dëgjohet në incizim.

31.Shqyrtimi i informatës mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: drejtorja për ÇPJ informon se nga pagesat e panove reklamuese ka gjeneru 59,680.00 euro të hyra, nga objektet e përkohshme 5635euro, nga këmbimi i pronës private me pornen komunle ka ps të hyra prej 75.115.00euro që janë kry procedurat e më hershme. Nga data 30.01.2025 e deri me datë 30.04.2025 drejtora për ÇPJ ka të hyra 140,468.00 euro. Ndërsa pronat komunale të jepuna në shfrytëzim janë parkingjet rr.Mbreti Pirro, rr. Adem Jashari, rr.Mbretëresha Teutë, rr. Tomi Bler, rr.Nëna Terez, dhe rr. Medlin Ollbrajt. Të gjitha keto prona janë që Komuna e Pejës i ka të jepme në shfrytëzim.

32.Shqyrtimi i informatës së Drejtorisë për Administratë, mbi funksionimin e Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: drejtoresha e administrates, nuk është prezent për shkak të një takimi zyrtar, raportin e marr dhe janë të përshkruara të gjitha takimet që janë mbajt nga bashkësit lokale, nese ka dikush diqka e hapim diskutimin!

Znj. Hidajete Krasniqi:edhe pse po më duket e paarsyshme pasi që nuk është drejtoresha nuk e dim se kujt me ju referuar, e kam analizuar mirë raportin për Këshilla Lokal, mendoj që është një raport copy past i vitit të kaluar. Ne pak më par e votuar rregulloren për transparencë dhe me ndoj që ish dasht me qenë transparent. Se nese shkruhet që në çdo bashkësi lokale janë mbajtur shumë takime nuk ceket, nuk raportohet për një procesverbal të pakten data kur është mbajt një takim. Por janë mbajt shumë takime prej fillimit deri në fund të raportit. I njeiti ka qenë edhe vitin e kaluar dhe të njeita vërjetje i kam pas dhe mendoj që nuk është transparent, dhe është një raport që është dasht të analizohet dhe të dokumentohet me një procesverbal se ku janë mbajt ato takime që janë të shumta nëpër bashkësi lokale.

Z.Gazmend Turku: sa i perket raportit dhe procesverbalit të gjitha takimet janë mbajt dhe kush ka qenë pjesëmarrës të gjitha janë të vërtetuara në dokumentacion. Unë, sot kam ardh në cilësinë e kordinatorin, mirpo drejtoresha Nita mundet me ti vërtetu të gjitha në dokumentacion. Sa i perket raporti që the është copy past, zakonishtë raportet e bashkësive lokale nuk kanë shumë dallim, ka dallim vetem tek numri i kërkesave.

Znj.Hidajete Krasniqi: në raport aty ku shkrun që paraqesin kërkesat nuk jam e sigurt mundem me ju adresu se cila bashkësi lokale, mirpo mbasi jemi në muajin e 5-të, a është dasht komuna me ju kthy një përgjigje atyre që kanë kërku dhe kërkesat e tyre a janë realizu apo nuk janë realizu? A është e arsyshme kjo?

Z.Gazmend Turku: shumë të drejtë keni dhe mendoj që znj.Nita mundet me ju jep sqarim a janë realizu apo jo për vitin 2024! Ndërsa për vitin 2025 jemi në fillim kemi kohë dhe jemi të hapur edhe për bashkëpunim dhe për bashkëbisedim.

Z.Islam Husaj: ky raport për këshillat lokale është një raport periodik i cili ofron të dhëna për një periudh kohore tremujore dhe ne vazhdimisht e kemi këto raporte. Unë pajtohem me znj.Hidajete që foli në fillim. Ka mundësi me përmisim të raportit. Ne e dim që raporti nuk i përmban të gjitha elementet sepse kishte me u bo veten raporti i këshillave lokal një mbledhje, mirëpo mundet me u përmirësu. Vërtet për shembull ne kemi specifika të cila këshillat lokal i kanë pas gjatë kësaj periudhe kohore dhe mundet me u përmend ndonjë kërkesë e tyre ose ndonjë çështje në raport. Nuk po kërkojmë gjithëcilën kërkesë që është bërë të këshillave lokal. Por qato qka janë më të rëndësishme me i specifiku dhe me i parqit si të tilla. Ne në rregullore kemi thënë që duhet me i mbajt gjashtë takime minimumi dhe nese ju kujtohet janë dy vite që po kërkoj me u ndryshu rregullorja për këshilla lokal dhe rregullorja për dekorata. Nuk po dëgjon kërku. Kërkesat e mija po ecin qeshtu , tash është shumë vonë për ketë mandat. Duhet në mandatin tje ardhshem me i ndryshu këto dy rregullore. Përndryshe ka me pas gjithmonë pa knaqësi sespe rregulloret nuk janë të qarta. Po ashtu deshta dhe një çështje zakonishtë kemi pas në rend dite planin e punës së kuvendit? Çka ka ndodh sivjet? A mundemi na në ketë periudhën e ardhshme deri në seancen tjetër me mujt me realizu?

Z.Labinot Panxha: më shtyri me mar fjalën një fotografi ketu përpara të drejtorëve të pandergjegjshem ndaj neve dhe para qytetarëve. Drejtor Naser a ki zyrtar ti në drejtorinë tënde? Athere mundësisht në takimin e radhes e dërgon një zyrtar dhe ju mos hajdeni asnjë kurrë. Ju drejtorat mos hajdeni e nënpunësat civilë vini ktu edhe pse skanë obligim ligjor, as nuk i përcakton rregullorja e punës së tyre. Ju drejtorat shetitni posht e përpjet sepse në fund të fundit qytetarët ju kanë sjellë aty, qështu jeni duke ja kthyer me të mirë kësaj far pune.

33.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar.

Nuk ka pasur

34.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Z.Feriz Gashi: unë vetem deshta e mbështet se qka tha z.Labinoti. Pata pyetje për drejtorinë e shëndetësisë dhe për kryetarin. Për kryetarin në rregullë sespe e argumentut që ka takim zyrtar, mirëpo kta drejtorat sinqerishtë duhet me qenë deri në fund ose kryesus më mirë me shku me

rend të përmbysur. Po e nxjerrim piken e fundit, po e nxjerrim në piken e parë çka kemi për çështjet e ndryshme i diskutojmë pastaj le të shkojnë kur dojnë!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: kur e diskutojmë Planin e Punës së Kuvendit mundeni me i paraqit në diskutim.

Znj.Hidajete Krasniq: duhet me falenderu drejtorinë e arsimit që çdo here po gjenë kohë dhe po rrin deri në fund. Kam kërku edhe heren e kalaur keni një informatë për vizitat sistematike që janë kryer vitin e kaluar, cilat janë ato të gjeturat që ata i kanë gjetur tek fëmijet gjatë vizitave. Edhe ku jemi me vizitat sistematike të këtij viti? A janë duke vazhduar? Edhe pse në plan kanë qenë dhe po doket shkollat e njëjta me vitin e kaluar. Nuk po të kërkoj sot përgjigje drejtor, por mundesh për seancën tjetër. Kam edhe një kërkesë nga banoret e rr.12 Qeshori që të dërgon për te restaurant “Era” për rregullimin e rrugëve pasi që e kemi problem kalimin me makina. Çështje tjetër e ngritur është se çka po ndodhë me renovimin e teatrit të qytetit “Istef Begolli”? përveq që qyteti ka mbetur pa shfaqje teatrale dhe stafi i teatrit ka mbetur pa puntorë. Çështja tjetër është nga të rinjet e Lugut të Barnit për ndërtimin e fushës së sportit në Baran pasi që po futëbollistet dhe dashamirësit e futbollit tashe 6 vite po duhet të udhëtojnë nga 20 -30 km të shiqojnë ndeshjet si vendorë.

Z. Drin Veselaj: unë kam 11 çështje me i ngritë nga qytetarë , por fatkeqësishtë nuk kam kujt me ju drejtu. Megjithë respektin për drejtorët që na respektojnë. Problemi është tek vullneti i drejtorve për me qenë ktu , edhe nese e qesim piken e fundit të paren, ata kanë me ardh në piken e fundit. Ata e kanë punë, 08:00:16:00 edhe duhet me ardh ktu se i obligon edhe ligji edhe të gjitha. Mirëpo është mungesë respekti edhe mungesë guximi për me ardh ktu me u përballë me asambleistë të cilët gjatë gjithë kohës mundohen me i pasqyru problemet dhe kërkesat e qytetarëve. Siq e thashe dhe ne fillim e mira e gjithë kësaj është që shumicen nga atyre që i kemi nuk kemi me i pa përballë.

Z.Labinot Panxha: unë dua ti ngrisë disa shqetësime të qytetarëve pamvarsishtë që ata që duhet mu përgjigjë nuk janë këtu. Shqetësimi e qytetarëve që kanë të bëjnë me infrastukturen rrugore dhe bujqësore. Fillimishtë më lejoni ti paraqes shqetësimet e fsh.Kosuriq ku si rezultat i mungeses së ndërtimit të kanalit të ujitjes që kalon përmes oborreve të famijles Shkreli, Dezdari, Muhaxheri, sa here që bujqit i ujitin tokat në oborret e ketyre familjeve vërshohen nga uji dhe ju sjellin edhe shumë dëme materiale. Sepse në atë vi ku unë po diskutojë derdhen edhe ujërat e zeza në mungesë të kanalizimeve dhe ka rrezik të infektimit me ndonjë sëmundje. Prandaj, kërkoj nga ju që të merni veprime konkrete për zgjidhjen e këtij problemi për ata banorë. Po ashtu edhe nga takimet me qytetarë kam pasur pyetje nga ata të cilat po i parashtoj para juve dhe kërkesë kryesore e tyre ka qenë çka po ndodhë me rrugët të cilat janë të kubëzuara , përfshir këtu edhe rrugët të cilat parafolësja ime znj.Hidajete i ceku. A do të ndërtohet ato rrugë me asfaltë apo do të qëndrojnë ashtu mizerje qysh janë në menyren më të keqe të mundëshme. Po ashtu i shoh të nevojshme me i cekë edhe emrat e atyre rrugëve duke fillu nga rrugët “Kulla Sheremeti, “Shallaku i Boshatlive” , “ Bakera Adem Gjuka”, “ Naim Frashëri”, “ Fan Noli”, “ Mbreti Zog”, “Çajupi”, “Cen Avdyli”, “ Sali Ukella”, “ Kahreman Malushaga”, “ Halil Agusholli”, “ Wesley Clark”, dhe “Ahmet Gjokolli”. Këto rrugë janë shumë të dëmtuara dhe kush do që kalon në këto rrugë përballat me lloj-lloj dëmësh në automjetet e tyre. Prandaj është e domosdoshëme që të njëjta të asfaltohen, janë të pa mirëmbajtura dhe në gjëndje katastrofale.

Z.Islam Husaj: ato rrugë që i përmendi z.Labinot i ke pa qashtu po nuk ke me i pa mo, sespe ato kanë me u asfaltu të gjitha vetem j'a kanë fillu. Deshta një çështje me ngritë në komitetin për shëndetësisë ne e kemi diskutu dhe kemi ardh në përfundim që duhet me bë një rekomandim për drejtoratin e shëndetësisë. Fjala është në udhëzim administrativ të cilin e ka dërgu ministria e shëndetësisë udhëzimi 03/2024 për bashkë-pagesa e që mendojmë që është në kundërshtim me ligjin për shëndetsi. Sepse në udhëzim administrativ në piken 7. thuhet se personat të cilët kërkojnë shërbime mjeksore jashtë zonës ku banojnë duhet me i pagu 5 euro,qoftë fëmijë, pensionistë, ai me sëmundje kronike, ai me kancer me çfarëdo qoftë. Domethënë ligji i liron këta njerzë dhe nuk e specifikon aty që vetem në shtëpinë e vet janë të liruar. Këta janë të liruar kudo në Kosovë.Ky ligj vlen për krejt territorin e Kosovës dhe kudo që vizitohet ai është i liruar nga bashkë-pagesa. Udhëzimi administrativ është në kundërshtim me atë dhe ne kemi kërkuar i kemi rekomandu drejtoratit që përkohësishtë me pezullu vendimin që e ka marr drejtorati i shëndetësisë, për implementimin e kësaj rregullore dhe udhëzimit administrativ dhe njëherit me pezullu edhe vendimin i cili e ndalon viziten, i kthen vizitat sespe e pyet prej nga je i tregon atahere i thotë kthehu. Pamvarshishtë gjendjes dhe situatës që e ka . Kjo të bëhet deri në momentin kur krijohet lista e pacientëve, fillon implementimi i mjeksësisë familjare, kur bëhet regjionalizimi i pacientëve, krijohen listat e pacientëve, ndahen pacientët për mjek atëherë mund të bëhet ajo. Tash për tash asnjë veprim nuk është bërë në regjionalizim të pacientëve. Prandaj duhet që deri sa të bëhen disa veprim paraprake, drejtorati i shëndetësisë duhet me i pezullukëto dy vendime.

Z.Drin Veselaj: doktor nuk më falenderove që ky është edhe kontribut i imi kjo.

Z.Islam Husaj: me shkrim do ta dorëzoj atje edhe nënshkrimet e anëtarëve që janë nënshkru z.Drin Veselaj,z.Islam Husaj, znj.Arjeta Musliqi, znj.Najqe Kelmendi.

Z.Naser Gega: lidhje me vizitat sistematike ato shkolla që kanë qenë mirpo janë zgjeru edhe shkolla tjera, janë edhe shkollat e fshatrave mirpo kemi vonesë në transportë. Janë duke vazhduar me të njejtin synim siq ka qenë më heret prej të gjeturave nuk i kam statistikat e sakta mirpo prej asaj që di është vërjet tek fëmijët probleme me peshen e qantës, problem me të pamun dhe probleme me dhëmbët.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **14:40** h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=iJkVa-Sg9S8>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

KRYESUES I KUVENDI,
z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 17 Korrik 2025, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe miraton i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Buca nga Republika e Turqisë, siç u është prezantuar anëtarëve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 016-01/45454
Pejë, date: 17 Korrik 2025

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52, pika 2, të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 17 Korrik 2025, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe rekomandon raportin e punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2025, si raport informativ siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 016-01/49209
Pejë, date: 17 Korrik 2025

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 17 Korrik 2025, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe rekomandon raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2025, si raport informativ siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400/01-49212
Pejë, date: 17 Korrik 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUES I KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj**





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 17 Korrik 2025, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe rekomandon raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2024 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2024, si raport informativ siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 016-01/49432
Pejë, date: 17 Korrik 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**





**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 17 Korrik 2025, në propozim të Kryetarit të Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit të Komunës së Pejës të shqyrton dhe rekon andon informatën nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmërsë dhe testit të maturës, si pikë informative siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

**I. Numër: 400-01/49205
Pejë, date: 17 Korrik 2025**

**KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-**

**KRYESUESI KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj**





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008, nenit 51 pika 1.8 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 17.07.2025, nxjerr këtë:

K o n k l u z i o n

- I. **I propozohet** Kuvendit Komunal në Pejë kërkesa e drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për Buxhetin të Bashkëfinancimit Komunal - Fermer për **Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës** me bashkëfinancim” për një pike në seancën e kuvendit (aneks për fermerët në listën e pritjes, aplikues në thirrjen publike të datës 04.02.2025) të jetë pikë në renditje ditës.
- II. Ky projekt do të realizohet sipas Thirrje Publike të datës 04.02.2025 – **“Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës”**.
- III. Realizimi i këtij aneksi projekti bëhet me qëllimin e përkrahjes së fermerëve/bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim, Komuna 70%, dhe participimi i fermerëve 30%.
- IV. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,
- Anëtarëve të Kuvendit Komunal në Pejë,
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë dhe
- Arkives.

L.nr. 420/01-51748 / 2025
Pejë, 17 korrik 2025





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Pejës

Opstina Pec
Peja Municipality

Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike /Direktorat za Komunalne i Javne
Usluge/ Directorate For Public Works and Services

DATË/A:	03.07.2025
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Z. Gazmend Muhaxheri – Kryetar i Komunës Z. Rexhep Kurtbogaj – Kryesues i KK Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Agron Nikçi – Drejtor i DPKSHP
NGA/OD/FROM:	Ilir Lulaj – Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Procesverbal/Raport nga mbajtja e konsultimit publik lidhur me: Draft – Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035 , për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, si dhe Raportin e Vlerësimit strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035 , për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik

Bazuar në njoftimin për konsultim publik të datën 17.06.2025, me datë 02.07.2025 në ora 10:00 Komuna e Pejës, përkatësisht Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, ka mbajtur konsultimi publik me qytetarë, OJQ dhe grupet e interesit lidhur me:

Draft – Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, si dhe

Raportin e Vlerësimit strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.



Në këtë konsultim publik prezent ishin:

- **Agron Nikçi** - Drejtori i DPKSHP dhe
- **Ilir Lulaj** – Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve DPKSHP
- **Vlera Krasniqi** – përfaqësuese e kompanisë hartuese të raportit për Vlerësimin strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035.

Hapja e këtij konsultimi (debati), u bë nga drejtori i DPKSHP Agron Nikçi i cili të pranishmëve ju uroj mirëseardhje dhe po ashtu i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrjen.

- Pastaj Z. Ilir Lulaj zyrtari i lartë për menaxhimin e projekteve në DPKSHP filloj me prezantimin e Draft – Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunitet e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik, e ku në mënyrë më të detajuar u prezantuan:
 - ✓ Qëllimin dhe rëndësia e planit;
 - ✓ Baza ligjore për hartimin e tij;
 - ✓ Nevoja për bashkëpunim ndërkomunal;
 - ✓ Përmbajta e planit;
 - ✓ Masat e parapara për komunën e Pejë, etj.
- Pas këtij prezantimi fjala ju dha Znj. Vlera Krasniqi - përfaqësuese e kompanisë hartuese të raportit për VSM, për prezantimin Raportit për Vlerësimin strategjik mjedisor për Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunitet e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.

Znj. Vlera Krasniqi përshëndeti të pranishmit si dhe paraqiti aspektet kryesore të raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Ndërkomunal të Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit. Ndër të tjera theksoi se Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Rajonin e Dukagjinit dhe VSM ka për qëllim ruajtjen e ambientit si dhe resurseve tjera natyrore, mbylljen e deponive të hapura, krijimin e oborreve ricikluese, infrastrukturës tjetër përcjellëse si dhe ruajtjen e ekosistemit në rajonin e Dukagjinit, rajon ky i cili është i njohur për pasuritë e shumta natyrore. Po ashtu ajo i njoftoj të pranishmit se bazuar në ligjet e aplikueshme në vend para fillimit të ndërtimit të objekteve dhe infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave, për secilin objekt duhet të hartohen raportohen e vlerësimit të ndikimit të mjedis ku në kuadër të tyre adresohen të gjitha ndikimet në mjedis gjatë procesit të ndërtimit dhe operimit të tyre.



Pas prezantimit të mësipërm u hap diskutimi ku të pranishmëve ju dhe mundësia për marrjen e fjalës për parashtrimin e pyetjeve dhënies së komenteve, vërejtjeve apo sugjerimeve të ndryshme.

DISKUTIMI:

- **Xhevat Kajolli** – qytetar parashtroj pyetjen: “Si mund të bëhet parandilimi i vërshime në qytetin e Pejës”?

Përgjigje:

- Moderator i takimit e falënderoj për pyetjen lidhur me këtë shqetësim të qytetarëve të komunës së Pejës dhe po ashtu e njoftoj zotin Kajolli dhe se ky plan dhe VSM e trajtojnë çështjen e mbeturinave komunale për 5 komunat e Dukagjinit nuk e trajton problematikës e vërshimeve, shqetësim i cili do të duhej të studiohet dhe trajtohet me plane apo strategji tjera komunale apo të nivelit qendror.

- **Ismet Rexhaj** – qytetar parashtroj pyetjen: “A janë të parapara ndërtimi i kanalizimeve dhe impianteve për trajnimin e ujërave të zeza për fshatrat e komunës së Pejës e posaçërisht për lokalitetin ku aj banon”?

Përgjigje:

- Moderator i takimit e falënderoj qytetarin për pyetjen e parashtruar, e njoftoj se ky plan dhe VSM e trajtojnë çështjen e mbeturinave komunale për 5 komunat e Dukagjinit dhe jo ndërtimin e kanalizimeve dhe impianteve për trajnimin e ujërave të zeza. Lidhur me kërkesën dhe pyetje e tij atij ju rekomandua që kjo kërkesë të adresohet gjatë konsultimeve publike me qytetar lidhur me projekt buxhetin e Komunës së Pejës për vitin 2026, të cilat planifikohen të mbahen gjatë muajit të ardhshëm.

Pyetje të tjera nuk kishte, mbyllja e këtij konsultimi u bë nga moderatori ku u falënderuan qytetarët për kohën e ndarë për këtë debat, po ashtu u falënderuan për pyetjet dhe komentet e tyre si dhe u urua që në të ardhmen pjesëmarrja të jetë më e madhe.



PËRFUNDIM

Gjatë periudhës kohore 15 ditore gjatë konsultimit publik nga data 17.06.2025 deri me datën 02.07.2025, nuk ka pasur pyetje, kërkesa, vërejtje apo sugjerime. Duke pas parasysh pyetjet e parashtruara dhe të paraqitura më sipër, konsiderojmë se nuk ka kërkesa të cilat implikojnë të bëhen ndryshime eventuale në Planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik apo në VSM, apo të jepen sqarime për refuzimin e tyre.

Bazuar në këtë rekomandojmë procesimin e mëtutjeshëm për aprovim në Kuvendin e Komunës të Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2035, për pesë Komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik.

Pjesë e këtij procesverbali/raporti janë edhe fotot nga konsultimi publik dhe lista e pjesëmarrjeve.

Singerisht,

Ilir Lulaj

Zyrtar i lartë për menaxhimin e projekteve











Lista e pjesëmarrësve

Data: 02.07.2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Profesioni	Organizata	Nr.tel.	E-mail
1	IDRIZ SELMANAJ	ING. IDIRMANAJ		045108802	selmanej.22@hotmail.com
2	Skender Avdyli	ing. vateilic	Komuna	045110795	skender.d.avdyli@rks-gov.net
3	BESIR ULASJ	IDN.		044189415	ulabes@hotmail.com
4	ALTIN IBRAJ	ING. NOERTIMAR	K.K. PEJE	049126042	altin.ibraj@rks-gov.net
5	Kurbim Gjombaj	ING. Gjeolezi	K.K. Peje	044780058	gjombajkurbim@rks-gov.net
6	ILIR Kelmendi	ING. NOERT	K.K. PEJE	045112782	ilir.i.kelmendi@rks-gov.net
7	KUJTIM AHMETAJ	ING. ARKITEKTUR	K.K. PEJE	049684506	kujtim.ahmetaj@rks-gov.net
8	Andita Behrami	ING. IDENTIFIK	K.K. Peje	044457278	andita.c.behrami@rks-gov.net
9	MIRANDA MURIQI	ING. ND.	K.K. PEJE	049232020	miranda.murqi@rks-gov.net

10	EDISON MIALOLLI	ING. ELEKTRO	K.K. PEJE	049107000	EDISON.MIALOLLI@RKS-GOV.NET
11	Agnesa Morina Alijaj	Ing. Arkitekturi	K.K. Peje	049717191	agnesaa.ali@rks-gov.net
12	DORAT PODRINACI		PGJE	049464832	dorahidipi@gmail.com
13			Jabllanic e Vasec-Rij	044125028	
14	ismet Rexhaj		Jabllanic e Vasec-Rij	044182564	ismet.pahaj@hotmail.com
15	Xhevat Kariqi				
16	LUAN PAVATA	ASAMBLEJA	PEJE	049-930370	LUAN.PAVATA@RKS-GOV.NET
17	SHEMSUDIN ABASI	ING. NOERT.	PEJE	045-110801	shemsedinabasi@hotmail.com
18	ILIR LULAJ	OKONOMI	K. Peje	045/110799	ilirlulaj@gmail.com
19	Agren Nikci	ARKITEKTUR	K. PEJE	044/724111	agren.nikci@rks-gov.net
20					



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008, nenit 51 pika 1.8 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokollit L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri më datën 17.07.2025, nxjerr këtë:

K o n k l u z i o n

- I. **I propozohet** Kuvendit Komunal në Pejë kërkesa e drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për Buxhetim të Bashkëfinancimit Komunal - Fermer për **Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës** me bashkëfinancim” për një pike në seancën e kuvendit (aneks për fermerët në listën e pritjes, aplikues në thirrjen publike të datës 04.02.2025) të jetë pikë në renditje ditës.
- II. Ky projekt do të realizohet sipas Thirrje Publike të datës 04.02.2025 – **“Furnizim me mekanizëm bujqësor për fermerët e Komunës së Pejës”**.
- III. Realizimi i këtij aneksi projekti bëhet me qëllimin e përkrahjes së fermerëve/bujqëve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor me bashkëfinancim, Komuna 70%, dhe participimi i fermerëve 30%.
- IV. Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,
- Anëtarëve të Kuvendit Komunal në Pejë,
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë dhe
- Arkives.

L.nr. 420/01-51748 / 2025
Pejë, 17 korrik 2025

